



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:273857
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05620945

CAP.nr.1646/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individual Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjellësit në Mitrovicë, kundër debitorit Sh.K. nga Mitrovica, Rr. ‘’...’’, me bazë juridike përmbartimore-borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.1155/21 të datës 28.07.2022, me datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e debitorit Sh.K. nga Mitrovica, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.1155/21 i datës 28.07.2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.1155/21 të datës 28.07.2022, ka hedh poshtë si të pas afatshëm prapësimin e debitorit Sh.K. nga Mitrovica, i paraqitur ndaj urdhrorit të përmbartuesit privat Isa Shala me seli në Prishtinë, P.nr.380/20 të dt.27.08.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovoj ankesën dhe të ndryshoj aktvendimin e atakuar.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve të shfrytëzimit të ujit të pijshëm nr.10607, lidhur me borxhin në vlerë prej 1,026.24 euro. Përmbaruesi privat, ka lejuar përmbarimin e kërkuar me urdhrin përmbarimor P.nr.380/20 të datës 27.08.2020, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 05.11.2021. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimit, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vepruar kur ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.380/20 të dt.27.08.2020. Sipas nenit 70 të LPP-së, përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve, pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit 7 ditor. Në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se debitori urdhrin mbi lejimin e përmbarimit e ka pranuar me datën 27.10.2021, ndërsa prapësimin ndaj këtij urdhri e ka paraqitur me datën 05.11.2021, tek përmbaruesi privat Isa Shala. Nga kjo rezulton se prapësimi është paraqitur 2 ditë pas afatit të paraparë ligjor.

Afati kohor ligjor për ushtrim të prapësimit ka qenë afati prej 7 ditësh, i cili ligjërisht ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme prej kur debitori e ka pranuar urdhrin përmbarimor, që në rastin konkret i bie të ketë filluar nga data 28.10.2021, e ku me shikim në kalendarin mujor –tetor, nëntor për vitin 2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e ankesës – duke marr afatin e dhënë në këshillën juridike ka qenë data 03.11.2021, datë kjo kur edhe ka skaduar afati kohor i dhënë në këshillën juridike prej 7 ditësh. Meqë dita e fundit për paraqitjen e ankesës - pra data 03.11.2021 sipas kalendarit ishte ditë pune, atëherë afati i fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë kjo ditë- e mërkure, ndërsa debitori prapësimin te përmbaruesi privat e ka paraqitur me datë 05.11.2021, i njëjti është jashtë afatit të përcaktuar prej 7 ditëve.

Afatet kohore të përcaktuara me ligj, janë të pandryshueshme dhe nuk mund të zgjaten apo shkurtohen as me vendim të gjykatës e as me marrëveshjen e palëve. Afati ligjor ka karakter prekluziv, sepse veprimi procedural i lidhur për afatin ligjor nuk mund të kryhet pas skadimit të tij.

Numri i lëndës: 2021:273857
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05620945

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1646/2023 me datë 25.04.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti